

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Andy Carroll rikthehet në fushën e futbollit pas rrëfimit për sulmin seksual! Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/andy-carroll-rikthehet-ne-fushen-e-futbollit-pas-rrefimit-per-sulmin-seksual/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 00:06:35 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 23:58:18 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	54927da32b4ff3eaa2c72680a4829ab9418a29a8c495631a4ebf93597c0adc73
TEKSTI	2c7852427b78bb947c91a521482f71aa8c10f0aac0b76ad171805cccbfea41d2
PAMJA	a631b6e990356a1c87e319cc98e49c01a840dcf8920a1158b640e3e4d42ac183

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	27d2f217a9335ba6f33f455b17e051c5d46b3e3c6ff9557591d95aecc5c041d7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	8cdcccb8f94a4d3a75369d01f1cf38d166bf90d2d974f1490ecc5a6ac46b2a2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/27d2f217a9335ba6f33f455b17e051c5d46b3e3c6ff9557591d95aecc5c041d7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Celebrities Gossip Showbiz

Andy Carroll rikthehet në fushën e futbollit pas rrëfimit për sulmin seksual!



Redaksia K

28 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO

Andy Carroll është rikthyer në fushën e futbollit vetëm pak ditë pasi bëri publik rrëfimin e tij për një sulm seksual që, sipas autobiografisë së tij, e përjetoi në vitin 2021.

Ish-sulmuesi i Newcastle United, Liverpool dhe kombëtares së Anglisë u shfaq në ndeshjen e Dagenham & Redbridge kundër Hampton & Richmond Borough, duke u rikthyer në aktivitetin sportiv pas publikimit të historisë së tij personale.

Carroll, 37 vjeç, e ka rrëfyer ngjarjen në autobiografinë e tij të re, "Owning It". Ai tregoi se sulmi ndodhi në shtëpinë e tij, gjatë periudhës kur ishte pjesë e Newcastle United.

Sipas rrëfimit të futbollistit, autori ishte një mik i ish-partneres së tij, i cili kishte qëndruar në shtëpinë e **Carroll** pas një mbrëmjeje ku kishin parë së bashku një ndeshje boksi. Carroll tregoi se ishte në gjumë kur kuptoi se po sulmohej seksualisht.

Pas ngjarjes, ai e nxori burrin nga banesa dhe, kur ai tentoi të rikthehej, e goditi duke e lënë pa ndjenja. Më pas njoftoi policinë.

Personi përgjegjës u shpall fajtor për vepra seksuale dhe u dënua me tre vite burg. Carroll dëshmoi edhe gjatë procesit gjyqësor, të cilin e përshkroi si një përvojë jashtëzakonisht të vështirë.

Në autobiografi, ai shkroi:

“ U sulmova seksualisht, ja ku e thashë. Është e frikshme edhe ta mendosh dhe vetëm pak njerëz e dinin për këtë deri tani.

Carroll shpjegoi gjithashtu se vendimi për ta bërë publike historinë nuk ishte i lehtë. Ai tha se diskutoi gjatë me partneren e tij, Lou Teasdale, përpara se të vendoste ta përfshinte rrëfimin në libër.

“ Është e frikshme të flasësh për këtë, por më ka bërë njeriun që jam sot, po aq sa edhe gjërat e mira. Dhe nëse të folurit për këtë më ndihmon të paktën një person, atëherë ia ka vlejtur

– shkroi ai.

Futbollisti pranoi se ngjarja kishte ndikuar në shumë aspekte të jetës së tij, përfshirë edhe karrierën sportive.

“ Ajo që më ndodhi ndikoi në çdo aspekt të jetës sime. Mendoja për të çdo ditë, duke e bërë të vështirë të përqendrohesha në çdo gjë tjetër, përfshirë futbollin. Trauma e asaj që më ndodhi nuk është zhdukur

-tha Carroll.

Aktualisht, Carroll është lojtar dhe bashkëpronar i Dagenham & Redbridge, klub që garon në National League South. Rikthimi i tij në fushë erdhi pak ditë pasi ai vendosi të fliste publikisht për një përvojë që për vite me radhë e kishte mbajtur private.



Ish-sulmuesi i njohur i Anglisë rrëfen traumën: “Jam sulmuar seksualisht nga një personazh i njohur...”

1.5 MIN



Andy Carroll rrëfen për herë të parë sulmin seksual: “Ishte e frikshme edhe ta mendoja”

3.5 MIN



I dehur i bërtiti dhe e ofendoi, ish-futbollisti i njohur pajtohet me të dashurën!

1.5 MIN

MË TË LEXUARAT



Punë e pagëndrueshme dhe pension i hershëm, studimi zbulon lidhjen me plakjen e trurit!



Gjiganti italian i modës Gucci nxjerr në treg atlete “Made in China”!



Tanimë gjërat kanë ndryshuar/Shenjat e zodiakut që më në fund po fillojnë një kapitull të ri të jetës së tyre!




Nations League, sonte SHQIPERË vs. BJELLORUSI/Ekskluzivisht në DigitAlb!



Aksident në Fushë-Krujë/Përplasen 3 automjete, humb jetën një 19-vjeçar!



“The Real Rooneys” përballet me kritika? A është jeta e Wayne dhe Coleen Rooney vërtet kaq autentike?



“Send Nudes”? Sydney Sweeney shfaqet provokuese në një tjetër fushatë?



A kaloni shumë kohë ulur? Ja çfarë mund të ndodhë nëse ecni çdo gjysmë ore!



A ju ndodh të shihni të njëjtën ëndërr vazhdimisht? Çfarë mund të fshihet pas saj?



Cindy Crawford përjetoi vite të vështira për djalin e saj?

EDITORI SUGJERON



Apple surprizon me risitë, AI bën gabimin e frikshëm dhe Tesla rikthen makinën që "fluturon"!



As viti i shtatë dhe as i dhjetë, ja se kur tradhtojnë çiftet në një lidhje...



Pas 8 vitesh pritjeje, Tesla Roadster rikthehet me një premtim të çmendur: Makina që mund të fluturojë?!



Një identifikim i gabuar nga AI ngriti në këmbë ushtrinë e SHBA-së, gati për sulm! Ja si ndodhi gjithçka...



Apple Watch tani "dëgjon" bisedat tuaja dhe i përmbledh për ju?! Risia që po ngre pikëpyetje...



Keni rënë në dashuri?! Apo është thjesht...



Apple më në fund palos iPhone-in dhe vjen me "iPhone Duo"... por a ia vlen 1,999 dollarë?



iPhone 18 Pro pas një jave përdorimi/ A ia vlen vërtet ta ndërroni telefonin sipas Mateo Kadriut...



Do të habiteni kur të zbuloni fuqinë e kanellës!



A mund të konsumoni kafe gjatë ushqyerjes në gjiri?! Ja se çfarë thotë studimi...

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania

Email:

Tel: +355 69 208 0500

+355 69 442 8873

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

LINKS

Kontakti
Marketing
Frekuencat
Aksesueshmëria
Mundësi Punësimi
Privacy Policy & Terms

JavaScript is required for tabnav widget to work properly.

Pamja këtua është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.